

Shpallet 1 pozicion pune pranë Qendrës së Pritjes për Azil (QPA) – Afatet, dokumentacioni

Në mbështetje të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në RSH”, i ndryshuar, neni 19 pika 1, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”; të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe në mbështetje të Vendimit Nr.39, datë 24.01.2024 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024, në njësitë e Qeverisjes Qendrore”

Qendra e Pritjes për Azil (QPA) shpall 1 vend vacant me kontratë të përkohshme 1-vjecare:

1. Kujdestar Nate- Klasa e pagës V

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS

Kujdeset gjatë natës për Azilkërkuesit e Qendrës së Pritjes për Azil.

DETYRAT KRYESORE

- a) Puna e kujdestarit të natës konsiston në ruajtjen e qetësisë në Qendër gjatë natës.
- b) Ndërhyrjen në zgjidhje të konflikteve ndërmjet azilkërkuesve.
- c) Zgjidhjen e situatave që mund të lindin gjatë natës në ambientet e qendrës si dhe mbajtjen nën kontroll të tyre.
- d) Njofton drejtuesin e institucionit dhe sipas rasteve policinë, ambulancën, zjarrfikëset nëse do të jetë e nevojshme, në raste konflikti.
- e) Në raste të veçanta kur mbërritja e azilkërkuesve në Qendër bëhet në orarët e vona, kryen akomodimin e tyre.
- f) Në rastet kur gjatë natës ka persona me shqetësime shëndetësore, i shoqeron në bashkëpunim me shoferin dhe infermieren në qendrat spitalore përkatëse.

Kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët për këtë pozicion:

Arsimi: I ulet.

Përvoja: Përvojë pune.

Tjetër: Aftësi për të organizuar punën në mënyre komplet autonome, duke përcaktuar përparësitë, marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse dhe respektuar limitet e caktuara. Aftësi për t'u adaptuar në ambiente dhe kultura të ndryshme pune, fleksibile dhe aftësi për vetë iniciativë.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit të aplikimeve

Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet:

1. CV dhe Letër motivimi;
2. Diplome e Shkollës 8-vjecare të noterizuar së bashku me listë notash;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
7. Dëshmi Penaliteti;

Mos dorëzimi i dokumentave të mësipërme dhe mosplotësimi i kriterëve, e skualifikojnë automatikisht aplikantin.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, duhet të bëhet brenda datës **07.02.2024 ora 10:00**, në rrugë zyrtare ose dorazi në protokollin e Qendrës së Pritjes për Azil, me adresë Rr. "Myslym Keta", Babrru, Tiranë.

Zhvillimi i intervistës me aplikantët e përzgjedhur nga komisioni "Ad-hoc" **brenda datës 08 Shkurt 2024 ora 10:00** si dhe njoftimi i kandidatit të suksesshëm **brenda datës 09 Shkurt 2024. Vetëm kandidatët të cilët përmbushin kriteret do të përzgjidhen dhe do të njoftohen për intervistë pranë Qendrës së Pritjes për Azil.** Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.